

NJOFTIM MBI RUAJTJEN E PRIVATËSISË

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë suaj ju tregon se çfarë duhet të prisni kur Prokuroria e Përgjithshme mbledh të dhënat tuaja personale, si pasojë e ndërveprimit me faqen Web të Prokurorisë së Përgjithshme. Përpunimi i të dhënave personale në përmbajtje të kësaj faqeje Web bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori”, miratuar me urdhrin nr. 122, datë 10.04.2013, ndryshuar me urdhrin nr. 213, dt. 22.07.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Informacioni ka vlerë vetëm për faqen e internetit të Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë (<http://www.pp.gov.al>) jo për faqet e tjera që mund të aksesohen nga përdoruesi nëpërmjet lidhjeve të përfshira në këtë faqe.

Informacioni mund të ndryshohet për shkak të zbatimit të rregullave të reja në këtë drejtim, prandaj, përdoruesi është i ftuar të kontrollojë periodikisht përmbajtjen e kësaj faqeje.

Rregullorja e Prokurorisë së Përgjithshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori

Rregullorja e prokurorisë ka si objekt përcaktimin e procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga organi i prokurorisë.

Gjatë përmbushjes së funksionit të saj, Prokuroria e Përgjithshme mund të mbledhë, mbajë, përdorë ose përpunojë të dhënat tuaja personale. Prokuroria e Përgjithshme e konsideron shumë të rëndësishme privatësinë dhe do të mbledhë, përdorë dhe përpunojë të dhënat tuaja personale vetëm në përputhje me legjilacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin procedural penal.

Kur vizitoni faqen e Internetit të Prokurorisë së Përgjithshme

Informacioni i loguar në server kur vizitoni faqen e Web të Prokurorisë së Përgjithshme është si më poshtë:

- Lloji i browser dhe sistemi operativ që ju po përdorni;
- Faqja referuese (për shembull, faqja e mëparshme që ju keni vizituar);
- Adresën IP të serverit tuaj (një numër i cili është unik për pajisjen me të cilën jeni lidhur në Internet; zakonisht një prej pajisjeve të ofruesit tuaj të shërbimit);
- Datën dhe orën e vizitës suaj; dhe
- Adresën e faqes së aksesuar dhe dokumentet e shkarkuar.

Ky informacion mblidhet vetëm për qëllime statistikore dhe studimi. Nuk bëhet asnjë përpjekje për të identifikuar përdoruesit.

Adresat e postës elektronike

Ne do të regjistrojmë adresën tuaj të e-mailit nëse ju do të na dërgoni një mesazh. Ajo do të përdoret vetëm për qëllimet për të cilat ju e vini në dispozicion. Në veçanti, ne nuk do ta shtojmë atë në ndonjë listë adresash elektronike përveç nëse ju e kërkonit këtë gjë dhe as nuk do të japim informacion lidhur me këtë adresë pa miratimin tuaj.

Kukit (Cookies)

Kukit janë të dhëna elektronike që i kalohen browser-it tuaj dhe që ruajnë informacione që mundësojnë funksionalitetet e faqes Web të Prokurorisë së Përgjithshme. Për shembull, preferencat tuaja për madhësinë e tekstit ruhen në një kuki dhe rishfaqen sërish në vizitat e mëpasshme. Kjo faqe Web-i nuk përdor asnjë kuki për të identifikuar përdoruesit ose zakonet e tyre të lundrimit në faqe.

Mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave tuaja personale nga Prokuroria e Përgjithshme, si subjekt i të dhënave personale referojuni edhe:

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar

https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/Ligji_9887_date_10_-03_2008_i_ndryshuar-2.pdf

Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori

http://www.pp.gov.al/web/urdher_nr_122_date_10_04_2013_per_te_dhenat_personale_1709.pdf;

http://www.pp.gov.al/web/urdher_231_2016_per_ne_rregulloren_e_te_dhenave_personale_1710.pdf

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tonë të privatësisë mund të dërgohen me e-mail në adresën: dpo@pp.gov.al

Në rast keqpërdorimi të të dhënave personale apo cënim të privatësisë nëpërmjet kësaj faqeje web-i, subjektet kanë të drejtën të ankohen pranë:

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nr. i Gjelbër: 0800 20 50 www.idp.al info@idp.al